

community

The New Apostolic Church around the world

01/2016/AI

Motoja e vitit 2016:

Të fitosh me Krishtin



Shërbesë fetare në
Auckland: Perëndia lidh një
besëlidhje me ne

Katekizmi: Kisha e Krishtit
dhe detyra, posti

Ftesë: Dita Ndërkombëtare
e Rinisë 2019

New Apostolic Church
International



Të fitosh me Krishtin

Të dashur motra e vëllezër të besimit,

ju uroj me gjithë zemër bekimin e Perëndisë për Vitin e Ri:

- ta ndjeni praninë dhe shoqërinë e tij,
- që ta mbani dashurinë e tij,
- dhe që ta përjetoni mëshirën e tij.

Ndryshimi i viteve na jep arsye për të ndalur pak dhe për të pyetur veten: „Sa shumë kam përparuar në rrugën drejt qëllimit tim?“

Për këtë ekziston një masë e thjeshtë. Përfytyroni ju lutem sikur shkoni drejt një shtëpie: në fillim qëllimi ju duket akoma i vogël, madje ju mund ta mbuloni pamjen me një gisht. Por sa më shumë t'i afroheni, aq më e madhe bëhet ajo dhe aq më qartë mund ta dalloni atë.

Qëllimi ynë është të jemi përjetësisht pranë Perëndisë. A i jemi afruar më shumë vitin që shkoi? A është Jezusi për ne sot më i madh se sa para një viti? A mund ta dallojmë ne më mirë natyrën e tij?

Për të ecur përpara na ndihmon vendosja e objektivave, e qëllime të ndërmjetme: „Me dashuri në punë“ – motoja jonë e vitit 2014 – kjo ishte një etapë.

Ose „Gëzim në Krisht“, motoja jonë për vitin që sapo shkoi – një tjetër rrugë.

Tani le të hedhim hapin tjetër: Perëndia na jep me anë të fjalës dhe shenjtërimit forcën për të luftuar atë çfarë na ndan nga ai. Ai na jep forcën për të dalë fitimtarë në këtë luftë

Ne duam të fitojmë me Krishtin!

- Krishti na ndihmon të triumfojmë mbi të keqen. Ai nuk e ka larguar atë nga bota, por e zotëron atë. Asgjë nuk mund ta ndalë Krishtin për të shpëtuar ata që i besojnë atij.



NAK International

- Krishti na ndihmon të triumfojmë mbi frikën: ne do të shqetësohemi përsëri edhe këtë vit për të ardhmen. Ndoshta jemi përpara vendimeve si të paralizuar, nga frika prej asaj që do të vijë. Por Jezu Krishti është aty për të na udhëhequr.
- Krishti na ndihmon të triumfojmë mbi veten:
 - mbi krenarinë që na pengon për të marrë ndihmën e Perëndisë,
 - mbi paragjykimet, të cilat na pengojnë të duam tjetrin,
 - mbi nxitjen për të shpallur opinionin tonë pa marrë parasysh paqen.

Po si mund të fitojmë me Krishtin?

- duke besuar në të vërtetën e Jezusit,
- duke dashur sipas mënyrës së tij,
- duke u mbajtur fort me këmbëngulje pas tij dhe
- duke kërkuar unitetin në bashkësi.

Këto janë vetëm disa mendime për moton tonë të re të këtij viti. Kemi një vit të tërë kohë për ta përpunuar më tej – një vit të tërë kohë për një hap tjetër të madh përballë qëllimit tonë.

Le ta bëjmë vitin 2016 vitin e fitores me Krishtin!

I juaji Jean-Luc Schneider

Perëndia lidh një besëlidhje me ne



900 pjesëmarrës të shërbesës fetare mbledhen së bashku në Auckland; 1100 të tjerë në South Island, Australi, në ishujt Fiji dhe në Papua-Neuguinea janë të lidhur me transmetim.

Foto: NAK Australi

Ligji i Përtërirë 5,3

“... e lidhi këtë besëlidhje jo me etërit tanë, por me ne që jemi këtu të gjithë të gjallë.”

Të dashur motra e vëllezër, jam për herë të parë këtu në Zelandën e Re. Kam dëgjuar nga apostuli i distriktit dhe nga vëllezërit, se Zelanda e Re është vend i bukur. Nuk kam parë akoma asgjë nga ky vend, por besoj atë çfarë më është thënë. Dëgjova gjithashtu se ka një bashkësi të mrekullueshme si dhe vëllezër e motra besimtarë. Edhe këtë e besoj, por sot mund ta shoh dhe ta perceptoj gjithashtu.

Dje ishim së bashku me fëmijët dhe përjetuam një ditë të mrekullueshme. Mbledhja e nxënësve të shkollës të së dielës ishte nën moton, që e kam parë edhe këtu në librat e këngëve: „Be about my Father’s business“ („... se duhet të jem në atë që i takon Atit tim“). Ju e dini se motoja i referohet një fjale të Jezusit, që e tha në moshën dymbëdhjetëvjeçare, kur prindërit e tij e kërkonin dhe e gjetën në tempull:

„Përse më kërkonit? A nuk e dini se më duhet të merrem me punët e Atit tim?“ Dhe kjo vlen natyrisht për të gjithë ne, jo vetëm për fëmijët. Ne duhet të jemi në atë që i takon Atit tonë. Tani këtë mund ta kuptojmë si detyrë, si detyrim dhe kjo nuk është fort e këndëshme: Unë DUHET të bëj atë që i takon Atit. Por këtu në fakt nuk bëhet fjalë se duhet të shkosh me patjetër në shërbesë fetare, se duhet të angazhohesh medoemos në kishën Apostolike të Re dhe nëse nuk e bën, atëherë ke për ta parë se ç'ndodh!

Le t'i hedhim një vështrim se ç'do të thotë: „... çfarë është e Atit tim“. Ose le të pyesim ndryshe: Cila është çështja e Atit tonë? Çështja e tij është që t'i shpëtojë njerëzit nga e keqja, nga padrejtësia dhe në fund nga vdekja. Për këtë punon ai. Për këtë ai sigurohet që të gjithë njerëzit ta kenë mundësinë e rënies në kontakt me Krishtin, që të kenë mundësinë e besimit tek ai dhe kështu të shpëtohen me anë të tij. Për këtë punon Ati ynë qiellor dhe ne kemi mëshirën e madhe, mundësinë si dhe detyrën për t'u bërë pjesë e kësaj, të bashkëveprojmë në këtë çështje. Ne vetë arrijmë në shijimin e shpëtimit dhe mund të ndihmojmë, që shpëtimi të jetë pjesë edhe i të tjerëve. Po ta shohim këtë kështu, atëherë mendoj se kjo moto nuk ka asgjë të detyrueshme, por të veprash sipas saj është një mëshirë dhe një burim gëzimi e bekimi. Jo vetëm fëmijët tanë por të gjithë ne, të dashur motra e vëllezër jemi të ftuar të jemi në atë çfarë i takon Atit tonë.

Tani dëgjuam një fjalë që iu ishte drejtuar në kohët e vjetra popullit të Izraelit. Bën fjalë për besëlidhjen, të cilën Perëndia kishte lidhur me popullin e tij. T'i kthehem shkurt historisë: Perëndia zgjodhi një popull, popullin e Izraelit. Me siguri jo popullin më të madh, më të fortë dhe më të rëndësishëm të kohës së tij. Nuk kishte asnjë arsye bindëse pse të

Fëmijët i urojnë me këngë mirëseardhjen apostulit kryesor dhe apostujtve që e shoqëronin.

Jo, besëlidhja, premtimi nuk i përkiste etërve tanë, por ne, të cilët jemi sot këtu dhe jetojmë.

zgjidhte pikërisht këtë popull, por Perëndia e pranoi atë në dashurinë dhe mëshirën e tij dhe lidhi me të një besëlidhje. Së pari ai e liroi nga skllavëria në Egjipt, nga dora e faraonit dhe në malin Horeb u foli: Ju duhet të jeni pronë e imja mbi të gjithë popujt. Kjo ishte pjesa e parë e besëlidhjes. Ai i drejtoi Izraelitët nëpërmjet Detit të Kuq dhe i çliroi nga dora e egjiptianëve. Ai u dha atyre një premtim dhe u foli rreth të ardhmes që kishte parashikuar për ta. Ata duhet të arrinin në një tokë ku buronte qumësht e mjaltë dhe u dha atyre ligjin lidhur me thënien, se do të bekoreshin nëse do të vepronin sipas tij. Kjo është shkurtimisht përmbajtja e besëlidhjes, që Perëndia bëri me popullin e tij. Nëse do t'i përmbahej besëlidhjes, atëherë do të ishte i bekuar.

E gjithë kjo, shpëtimi, kalimi nëpërmjet Detit të Kuq, besëlidhja, ngjarja në malin Horeb/Sinai qëndronte tashmë shumë kohë mbrapa dhe brezi, i cili e kishte përjetuar këtë kishte vdekur. Pas dyzet vjetësh nuk jetonte pothuajse asnjë nga etërit. Ishin vetëm Moisiu dhe një pakicë, të cilët e kishin përjetuar kalimin nëpërmjet Detit të Kuq dhe kishin qenë dëshmitarë se si vetë Perëndia i kishte folur popullit të tij. Të tjerët, që kishin qenë dëshmitarë, se si reja e mbuloi malin dhe u ngrit tym me bubullima e rrufe dhe u bë i dëgjueshëm zëri i Perëndisë, nuk jetonin më. Brezi, të cilit Moisiu tashmë u foli, e njihte historinë vetëm nga kallëzimet e etërve. Ju e dini se si shkon puna kur merr





Predikimi i Apostulit kryesor u plotësua në sherbesë fetare nga apostuli i distriktit Noel E. Barnes (në foto qëndron në altar) si dhe ndihmësit e apostujtve të distrikteve David Devaraj dhe John Fendt

diçka të thënë nga të vjetrit. Aty atëherë i thua vetes: „E pra, e gjithë kjo është ndoshta pak e ekzagjeruar.“ Njeriu nuk e ka përjetuar vetë diçka, pra shtrohet pyetja, nëse historia është e vërtetë ose ndoshta është zbuluar pak.

Por Moisiu u tha Izraelitëve: Ishte pikërisht kështu siç e dëgjua. Perëndia e ndau ujin dhe na udhëhoqi përmes Detit të Kuq, ai vetë na foli mbi mal!

Dhe më pas historia me tokën e premtuar. Populli e dinte, aty është ajo tokë e premtuar, por iu bë gjithashtu e qartë se duhet të luftonte për ta marrë atë. Tashmë shkretëtira qëndronte në atë kohë pas tyre dhe shumë afër ishte mendimi: Edhe këtu nuk është keq. Po, e kuptojmë, që etërit kanë ëndërruar në shkretëtirë për tokën e premtuar, se s'kishin asgjë, vetëm uri dhe etje, skamje, kishin mall për një shtëpi. Por shkretëtirën e kemi pas, mund të qëndrojmë edhe këtu. Do ta kishim mirë edhe këtu. Pse duhet të luftojmë akoma këtë betejë për tokën e

premtuar?

Moisiu e njihte këtë rrezik, prandaj tha: Jo, besëlidhja, premtimi nuk vlente për etërit por për ne, që jemi sot këtu dhe jetojmë. Perëndia dëshiron t'ju drejtojë për në atë tokë dhe ia vlen të luftosh për këtë çështje!

Jezusi vdiq dhe u ringjall për ty dhe do të vijë përsëri për ty, për shpëtimin tënd.

Moisiu ishte po ashtu i vetëdijshëm se populli do të binte tani në kontakt edhe me popuj të tjerë, te të cilët vlenin ligje të tjera. Aty izraelitët do të shihnin: se edhe pse atyre u lejohet të hanin mish derri apo u lejohet kjo e ajo, ata janë shumë mirë.

Jeta e tyre është po aq e mirë sa e jona, ata janë gjithashtu të lumtur, edhe ata kanë sukses. Aty vlen një ligj krejtësisht tjetër, por me sa duket edhe kjo funksionon. Pse duhet ta përmbushim ligjin me patjetër? A nuk mund të biem dakort për kompromise?

Kjo është arsyeja pse Moisiu thirri të gjithë popullin dhe

i tha se ligji vlen për ju, të cilët qëndroni këtu dhe jetoni.

Kjo sa për Besëlidhjen e vjetër. Tani vijmë në kohën e Besëlidhjes së re. Besëlidhja e re wshtw vazhdimi i së vjetrës: Perëndia dërgoi birin e tij, për ta shpëtuar popullin e tij; nëpërmjet sakrificës së tij, ringjalljes së tij dhe meritës së tij. Nxënësit e tij ishin dëshmitarë të gjithë kësaj. Ata e njihnin Jezusin, jetonin me të, flisnin me të, kishin takim me të ringjallurin dhe dalluan se: ai është vetw ai, qw vdiq dhe u ringjall nga të vdekurit. Ai e ka fituar fitoren. Jezusi u kishte dhënë atyre premtimin: „Dhe kur të shkoj, për t’ju përgatitur vendet, dua të kthehem përsëri dhe t’ju marr pranë vetes, që të jeni aty ku jam unë“. Ç’premtim madhështor!

Ai u dha atyre Ungjillin, u dha urdhëresat e tija dhe i mësoi ta mbanin fjalën e tij, atëherë do të ishin të bekuar. E gjitha



kjo qëndron para 2000 vjetësh. Dhe ç’është tani

Sot nuk mund të thotë askush: Kam parë të Ringjallurin! Mund të dëshmoj se ai është i vërtetë: Ai u ringjall, ashtu si tha. Dhe duhet të themi: Edhe vetë në krishtërim dëgjon zëra që thonë: „E pra, historia e vdekjes dhe e ringjalljes, kush e di nëse ka ndodhur kështu ... mos e kanë zbukuruar edhe atë pak? Mos duhet kuptuar simbolikisht, si një figurë? Aty bëhet fjalë për kuptimin dhe jo se duhet besuar, se ishte i vdekur dhe u ringjall. Që dikush duhet të vdesë për ne, për shpëtimin tonë, mos është pak e ekzagjeruar?‘ Sot janw tw shumë ata qw e shohin këtë si të huaj. Ky është një rrezik i kohës sonë.

Detyra e Testamentit të Ri, puna e apostujve, është dërguar nga Zoti për të dëshmuar sakrificën e Krishtit, vdekjen dhe ringjalljen e tij: Besoni në ringjalljen e Jezu Krishtit. Ajo është e vërtetë. Ajo çfarë qëndron e shkruar në Shkrimin e shenjtë mbi vdekjen dhe ringjalljen e Krishtit është e vërtetë. Kjo është përmbajtja e besimit tonë. Kjo është detyra kryesore e lajmëtarëve që zëvendësojnë Krishtin. Jezusi i dërgoi me fjalët: „Ai që ju pranon ju, më ka pranuar mua“, prandaj apostujt mund të flasin me autoritetin e Krishtit. Dhe cili është mesazhi të cilin duhet ta shpallin? Ata duhet t’u shpallin të gjithëve të vërtetën: Jezusi vdiq për ty, për ty që je sot këtu dhe jeton; besëlidhja e tij vlen për ty personalisht.

E gjithë kjo ndodhi për ty, për shkakun tënd, dhe kjo ndodh për ty për shpëtimin tënd: Jezusi vdiq dhe u ringjall dhe do të kthehet përsëri për ty, për shpëtimin tënd. Kjo është besëlidhja të cilën Perëndia lidhi me ty.

Kjo është detyra e punës së Testamentit të Ri dhe ne si apostuj nuk lodhemi së vepruari sipas kësaj detyre të Zotit dhe mjeshtrit tonë. Ne besojmë në vdekjen dhe ringjalljen e Jezu Krishtit, ne besojmë se Jezusi vdiq për ne, ne besojmë se ai do të vijë përsëri për shpëtimin tonë. Ky është premtimi i tij: Ti do të mund të hysh në mbretërinë e Perëndisë. Ti do të hysh në madhësinë, në bashkimin e përjetshëm me Perëndinë.

Disa mendojnë se ky mesazh ka qenë diçka për paraardhësit tanë. Ata jetonin në kushte të vështira, kishin për të bërë një luftë të fortë për të jetuar, duhet të përjetonin varfëri, vështirësi, sëmundje, luftë, disa rrezeqe e kriza, atyre thjesht ju

duhej diçka që t'ju jepte shpresë: Po, një ditë do të vijw shpëtimi! Atëherë çdo gjë do të bëhet më mirë!

Mendojnë se sot kemi një përkujdesje të mirë shëndetësore, nuk na duhet të preokupohemi më aq shumë dhe të kemi frikë nga e ardhmja. Ne e kemi jetën tonë nën kontroll, ekzistojnë zgjidhje për shumë probleme. Këtu në vend mbizotëron paqja dhe njeriu mund ta ndërtojë të ardhmen e tij. Ne nuk na duhet të shpresojmë për një të ardhme më të mirë në botën e përtejme. Njeriu mund ta realizojë këtu në tokë fatin e tij, nëse e shfrytëzon rastet siç duhet. Atëherë s'ke pse të ëndërrosh më mbi një përjetësi më të mirë. Aty s'ka rëndësi malli për bashkimin e përjetshëm me Perëndinë dhe pritja e mbretërisë së Perëndisë. Shumë njerëz nuk interesohen më për këtë.

Por në Besëlidhjen e re, Perëndia ka dërguar Shpirtin e shenjtë, i cili ka detyrën për të mësuar dhe për të lavdëruar Birin e Perëndisë. Ai na shpall madhësitinë e Krishtit, na drejton drejt njohurisë së Krishtit dhe na mëson, se ku qëndron madhështia e Krishtit. Jezusi thoshte për të: „Nga të mijat do t'i marrë dhe do t'ju shpallë. Gjithçka që ka Ati, ajo është e imja.“

Edhe sot është detyra e Shpirtit të shenjtë për të na treguar se cili është Krishti, për të lavdëruar atë, për të na drejtuar drejt njohjes së madhësisë dhe mëshirës së tij. Madhështia e tij është më e madhe se çdo gjë që mund të imagjinojmë. Bashkimi me Perëndinë është diçka kaq e mrekullueshme sa askush nuk e ka një ide për të. Shpirti i shenjtë na thotë: Beso në premtimet e Krishtit, ia vlen ta ndjekësh pas Jezusit. Ia vlen të ecësh në rrugën që të çon në mbretërinë e Perëndisë dhe në madhësitinë e bashkimit me të. Ti nuk do të pendohesh.

Posti i Besëlidhjes së re, posti i apostujve është dërguar po ashtu me detyrën e festimit të Darkës së shenjtë. Në çdo Darkë të shenjtë ne e forcojmë besëlidhjen me Perëndinë. Ne rritemi gjithmonë e më shumë në njohuritë e Jezu Krishtit. Sa më mirë ta njohim Jezu Krishtin, aq më shumë do të shtohet dashuria jonë ndaj tij dhe aq më shumë dëshira jonë për të qenë pranë tij. Ky është kuptimi i thellë i Darkës së shenjtë. Jezusi thoshte: „Nëse nuk e hani mishin e Birit të njeriut dhe pini Gjakun e tij, atëherë nuk keni jetë brënda vetes. Ai që ha trupin tim dhe pin gjakun tim, ai ka jetë të përjetshme.“ Që t'ja u shpallin një rrezve këtë, është

gjithashtu detyrë e apostulatit.

Jeta e përjetshme, bashkimi i përjetshëm në mbretërinë e Perëndisë është diçka kaq e madhe, sa ia vlen ta bësh rrugën për atje. Ajo tejkalon gjithshka dhe nuk mund të krahasohet me asgjë këtu në tokë. Por për ta arritur këtë është e domosdoshme marrja e Darkës së shenjtë dhe këtë ne e marrim në shërbesa fetare. Nuk mjafton të thuash: „Unë jam një i krishterë besimtar, unë jam një fëmijë Perëndie besimtar, unë bëj të mira ku mundem.“ Për të arritur në mbretërinë e Perëndisë duhet të marrësh atë ushqim, të cilin na e jep Zoti, Darkën e shenjtë, që ofrohet këtu në kishën e tij ku ndikojnë apostujt.

Ashtu si izraelitët, hëngrën mana në rrugën drejt tokës së premtuar, edhe ne na shërben Darka e shenjtë si ushqim në rrugën tonë. Pa atë nuk është e mundur.



Apostuli kryesor Schneider feston Darkën e shenjtë për shpirtat e atyre që kanë ndërruar jetë

Nuk është fjala se dua t'i bëj njerëzit të vijnë në shërbesë fetare, por nuk mund të rri pa thënë se marrja me dinjitet e Darkës së shenjtë është e domosdoshme për të qenë gati në rikthimin e Krishtit dhe për të arritur në bashkimin e përjetshëm me Perëndinë.

Rrezikun e parë që pa Moisiu e shohim edhe sot. Disa thonë: „Ky ligj i Perëndisë, urdhëresat dhe Ungjilli, ne njohim shumë njerëz, që besojnë në diçka tjetër. Ata kanë ligjet e tyre. Dhe shiko, ata janë të lumtur njësoj si ne. Ndoshta ndonjëherë edhe më të lumtur se ne. Dhe kjo madje ka

funksionuar te etërit e stërgjyshërit tanë, por sot kjo nuk shkon më. Ata kanë më shumë sukses se sa ne.“ Por atëherë duhet ta përcaktojmë suksesin. Jezusi tha: „Kush i pranon urdhërimet e mija dhe i zbaton ato, ai tregon se më do. Dhe atë që më do mua, do ta dojë edhe Ati im. Edhe unë do ta dua dhe do t'i zbulohem.“

Sigurisht që për t'u bërë i pasur, për t'u bërë i suksesshëm dhe i lumtur, për ta shpalosur veten këtu në tokë, nuk e ke të domosdoshëm Ungjillin. Për këtë ka shumë rrugë të tjera. Por për të përjetuar dashurinë e Krishtit, për ta njohur mirësinë dhe praninë e tij, për ta njohur atë, ekziston vetëm një rrugë: i bindur ndaj Ungjillit; zbatimi i tij në jetën tonë të përditshme, kjo vlente për etërit tanë dhe vlen edhe për ne sot. Këtë nuk e bëjmë për të pasur më shumë të ardhura, për t'u mbrojtur nga sëmundja, për të siguruar që fëmijët tanë do të marrin një zhvillim të mirë, por ne i bindemi urdhërimeve të Perëndisë, ligjit të Perëndisë, pasi duam të përjetojmë dashurinë e Jezu Krishtit. Ne duam të përjetojmë përkujdesjen e tij. Ne duam të përjetojmë gëzimin e miqësisë me Jezusin. Sa më me këmbëngulje ta ndjekim pas ligjin e Krishtit, aq më mirë e kuptojmë atë. Aq më mirë kuptojmë planin, të cilin ai ka për ne. Besëlidhja e tij, Besëlidhja e re nuk është për etërit, ajo është për ne, që jemi këtu dhe jetojmë. Ne jetojmë në besimin që Krishti vdiq për ne, dhe se do të na marrë pranë vetes kur të vijë përsëri. Kjo është besëlidhja e tij, që ka bërë me ne, ky wshtw premtimi i tij, përmbushjen e të cilit duam ta përjetojmë. Prandaj jemi në shërbesë fetare, prandaj është aq e rëndësishme për ne Darka e shenjtë dhe prandaj shqetësimi ynë është që ta shijojmë me dinjitet atë. Kjo është arsyeja pse duam të ecim në atë rrugë, që na e tregon Zoti. Për këtë arsye ne i bindemi atij dhe e përdorim Ungjillin e tij në jetën tonë të përditshme.

E di se në thelb kjo nuk është asgjë e re, por ndoshta është pikërisht kjo fjalë e sotshme e përcaktuar për ty ose për mua dhe ndoshta shërben, që ne të ndryshojmë diçka në jetën tonë. Kjo mund të ishte!



MENDIME THELBESORE

Ne besojmë se Jezu Krishti vdiq me të vërtetë për ne dhe se do të rikthehet përsëri, për të na marrë pranë vetes.

Ne kemi mall për madhështinë e përjetshme dhe marrim pjesë denjësisht në Darkën e shenjtë, në mënyrë që të arrijmë atje.

Ne respektojmë ligjin hyjnor në mënyrë që të përjetojmë praninë e Jezusit.

Paqja në botë – rreth rëndësisë së paqes botërore

„Paqe përballë frikës, ankthit të botës“ – kështu shkruhet në njërin prej këngëve apostolike të re të njohura të korrit. Këtë urojnë vetë të krishterët. Edhe Jezusi vetë u thoshte nxënësve të tij, se do të kishin frikë nëpër botë, megjithatë mund të ngushëlloheshin përsa kohë ai do të ishte me ta. Po sot?

A ka paqe në botë? Pothuajse jo. Vitin e fundit ka pasë 30 lufta, lufta civile shumica prej tyre me një numër të madh, të lartë viktimash, me vrasjen e njerëzve të pafajshëm. Bandat terroriste bëjnë ligësi, poshtërsi. Shumë njerëz nga Afrika Veriore ose nga Lindja e Afërme kanë frikë dhe largohen nga mizoria, largohen nga vdekja, lenë atdheun e tyre. Rrjedhat e refugjatëve kanë marrë përmasa të jashtëzakonshme.

Për këtë u krijua edhe dita ndërkombëtare e paqes. Ajo përsëritet çdo vit më 21 Shtator dhe drejtohet që nga Kombet e Bashkuara. Ajo vlen për të gjithë botën. Ajo ditë duhet të jetë një ditë armëpushimi, një ditë ku armët heshtin dhe njerëzit duhet të reflektojnë. E megjithatë këtë thirrje nuk e respekton askush. Kishat e krishtere në të gjithë botën e mbështesin këtë thirrje për paqe nëpërmjet lutjeve botërore. Këshilli ekumen i kishave u bën thirrje çdo vit rreth mbi 350 kishave anëtare, që të përfshihen në lutjet për paqe. Edhe Kisha Apostolike e Re vepron kështu. Kudo në botë bëhen lutje për paqe nëpër bashkësi të ndryshme. Këtë vit, UNO vendosi lutjen për paqe nën titullin „Miqësi për paqe – Dinjitet për të gjithë“ (“Partnerships for Peace – Dignity for All”).

Paqja sot

Një dokument i rëndësishëm i historisë njerëzore është edhe Karta e Kombeve të Bashkuara. Edhe neni i saj i parë e quan ruajtjen e paqes si synimin më të rëndësishëm të kombeve të bashkuara. Dikur quhej se ka paqe vetëm kur mungonte lufta, sot kuptojmë më shumë nën këtë përcaktim: respektimi i të drejtave të njeriut, parandalimi i konflikteve, çarmatimi, pedagogjia e paqes ose edhe një rehabilitim human pas konfliktit. Kombet e bashkuara kanë bërë publike materiale të shumta rreth kësaj. Të kuptuarit e sotëm e definicionit paqe është rritur – lista e luftrave

dhe e luftrave civile gjithashtu.

Kombet e Bashkuara, gjatë gjithë historisë së tyre, kanë ngritur institucione të shumta, qëllimi i të cilave duhet të jetë ruajtja e paqes botërore: si për shembull Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose (organizata e Kombeve të Bashkuara për arsim, shkencë dhe kulturë) UNESCO, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për refugjatët (UNHCR), Këshilli i të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe Gjykata penale ndërkombëtare. E megjithatë paqja e vërtetë nuk po vendoset.

Jezusi është paqja – Paqja është në Perëndinë

Të krishterët e dinë këtë. Ata e kërkojnë paqen tek Zoti, tek Jezu Krishti. Të jetosh në paqe është shumë më tepër se sa vetëm ta ruash atë. Shërbesat fetare të 23 Shtatorit do të mbahen nën titullin „Të jetosh në paqe“. Të jesh në paqe me tjetrin – kështu fillon gjithçka. Jezu Krishti është paqja jonë, këtë e dinë të krishterët. Ai sakrifikoi jetën e tij, me qëllim që njerëzit të mund të pajtoheshin me Zotin. Prej tij kanë rrjedhur edhe fjalët: „Paqen tuaj po jua lë, por po ju jap paqen time. [...] Zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë“ (Gjoni 14,27). Besimi tek Jezu Krishti të dhuron paqe.

Po ne? Çfarë mund të bëjmë ne?

Të kërkojmë paqe me të gjithë, shkruhet tek Letra drejtuar Hebrenjve (Hebrenjve 12,14). Një thirrje shumë e rëndësishme! Të ushtrojmë dashurinë ndaj tjetrit. Për ne tjetri është ai, të cilin Perëndia e ka vendosur pranë nesh. Ata që përpiqen për paqe janë të bekuar – a përpiqemi ne?





Baza të mira për vendime të mira

Armenia dhe Gjeorgjia, dy republika të dikurshme ruse, të cilat fituan pavarësinë më 1991 dhe janë nën përkujdesjen e zonës kishtare të Vestfalisë së Rinit Verior, qëndruan në gusht 2015 në programin e shërbesave fetare të apostulit kryesor. Në Gjeorgji kisha ka në dispozicion rreth katër kisha (ndërtesa) dhe një qendër për të rinjtë. Shërbesa fetare u zhvillua në kishën tonë në kryeqytetin Tbilisi (Tiflis).

Perëndia ka një qëllim: „Ai dëshiron të na shpëtojë. Kjo është puna e tij, të cilën dëshiron ta përfundojë“, bëri të qartë apostuli kryesor. „Në këtë vepër shpëtuese bëhet fjalë për ty – për ty personalisht.“ Dhe: „ajo çka vlen për ty, vlen edhe për mua dhe për të afërmin tonë.“

Perëndia „na lë gjithmonë zgjedhjen tonë të lirë, ai nuk na detyron kurrë për asgjë. – Ti dhe unë jemi absolutisht të lirë, ne mund të vendosim.“ Megjithatë: „ai dëshiron të na drejtojë, ai i flet zemrës sonë. Ai na tregon nëpërmjet fjalës së tij dashurinë e tij dhe durimin e Krishtit.“



Të shtunën motrat e vëllezërit i tregojnë apostulit kryesor kryeqytetin Tiflis. – Vendi me 4,5 milion banorë, ku 1103 të krishterët apostolikë në nëntë bashkësi janë veçse një tufëz e vogël.

Dashuria dhe durimi

Apostuli kryesor Schneider tregoi në mënyrë shembullore tre pika, me anë të cilave Shpirti i shenjtë zbulon dashurinë e Perëndisë.

- “Në dashurinë e tij, Perëndia dëshiron të të kthejë sërisht në shoqëri me veten e tij.”
- “Nga dashuria për njerëzit, Perëndia erdhi në tokë në formën e Jezu Krishtit, për të shërbyer.”
- „Perëndia na e jep këtë pa asnjë interes, veçse nga mëshira. – Asnjë njeri nuk është i mirë plotësisht për ta merituar këtë mëshirë.”

Edhe për durimin e Krishtit, apostuli kryesor përmendi tre pika:

- „Jezu Krishti vdiq për ty. Por sepse të do, ai e çoi planin e tij deri në fund.”
- „Nëpërmjet dashurisë së tij, Perëndia iu dha të tijëve forcën, ndihmën për të cilën ata kishin nevojë.”
- „Edhe nëse njerëzit nuk janë besnikë: Perëndia qëndron i tillë dhe vazhdon t’i ndihmojë ata.”

Baza të mira

Tani i mbetet njeriut të marrë vendimet e veta në bazë të vullnetit të lirë të dhënë nga Perëndia: „Perëndia pret nga ne, që të jemi fëmijë të matur të Perëndisë.” Kështu disa dëshirojnë vërtetë të ecin sipas vullnetit të Perëndisë, por në fund të fundit ua lënë vendimet të tjerëve – si fletëve më të dashura të biblës ose pikëpamjes së një vëllai administrate.

„Kjo është pamatur”, bëri të qartë apostuli kryesor Schneider. Pasi kush vepron kështu, i largohet përgjegjësisë së vet. „Ne vetë duhet t’i marrim vendimet. Por ne duhet ta bëjmë këtë, duke menduar me dashurinë e Perëndisë dhe

me durimin e Jezu Krishtit dhe vetëm kështu do të marrim vendimet e duhura.”

Vendime të mira

Si vendime të duhura mbi këtë bazë, drejtuesi i kishës quajti:

- „Unë dua t’i shërbej Perëndisë pasi e dua atë.”
- „Unë dua t’i shërbej të afërmit, sepse ai është po aq i çmuar për Perëndinë.”
- „Atëherë kërkojmë ndihmën e duhur” dhe i lutemi Perëndisë: „më jep edhe mua forcën të mbaj kryqin.”
- „Atëherë duam edhe ne të durojmë deri në fund.”
- „Atëherë duam edhe ne të jemi të duruar me të afërmin.”

„Ai që merr këto vendime i afrohet më pranë Perëndisë.”

MENDIME THELBESORE

2 Thesalonikasve 3,5:

„Edhe Zoti i drejtoftë zemrat tuaja ndaj dashurisë së Perëndisë dhe në durimin e Krishtit.”

Shpirti i shenjtë na shtyn për të dashur dhe për të duruar, duke na lënë të dallojmë dashurinë e Perëndisë dhe durimin e Krishtit.

Krijimi

ZANAFILLA 1

Historia e krijimit është historia e parë në Bibël. Ajo tregon se Perëndia, Zoti, krijoi qiellin dhe tokën, bimët, kafshët dhe njerëzit.

Në fillim Perëndia krijon qiellin dhe tokën. Toka është ende e zbrazët dhe e errët. Pastaj Perëndia krijon dritën. Ai ndan dritën nga errësira; Perëndia dritën e quan ditë dhe errësirën natë. Pastaj ai ndan tokën dhe ujin nga njëri-tjetri. Uji shndërrohet në përrenj, lumenj, liqene dhe dete. Më vonë Perëndia lë të rriten barëra, barna, lule dhe pemë që sjellin fruta. Çdo gjë rritet; toka bëhet ngjyra-ngjyra dhe e bukur. Perëndia vendos edhe drita në qiell: diellin, hënën dhe

yjet.

Mandej ai krijoi kafshët që jetojnë në det, si balenat dhe shumë e shumë të tjera si edhe zogjtë. Në det gëlojnë peshq, guacka dhe gaforre. Dhe në qiell zogjtë fluturojnë nëpër ajër.

Më pas e kanë rradhën të gjitha kafshët e tjara. Anekënd lëvrin diçka, hidhet dhe vrapon mbi tokë. Në fund Perëndia krijon njeriun; burrë dhe grua. Ata duhet të shumohen dhe të kujdesen për çdo gjë, që Perëndia, Zoti i krijoi.

Perëndia shikon gjithshka që krijoi – çdo gjë është mirë. Pastaj ai pushon.

Se si është krijuar bota, tregohet në Bibël në dy kallëzime të ndryshme. Ato ndodhen njëra pas tjetërs në fillim të Zanafillës. Kallëzimi i parë (shiko majtas) përshkruan të gjitha ditët e krijimit në një rregull të fortë, i cili i ngjason më shumë një numërimi. Këtu burri dhe gruaja krjohen njëkohësisht si shëmbulltyra të Perëndisë. Kallëzimi i dytë tregon në mënyrë më piktoreske. Ai përshkruan se si në fillim krijohet burri dhe më vonë krijohet gruaja nga brinja e burrit. Kallëzimi i dytë është më i vjetri.





PËR VIZITË TE CAMILA NË ÑEMBY (PARAGUAJI)

Përshëndetje! Unë quhem Camila, jam nëntë vjeçe dhe jetoj në Paraguaji. Ky është një vend në Amerikën e Jugut. Në Guarani, gjuhën e vendasve Paraguaji do të thotë: uji që rrjedh në ujë ose ndryshe: lumi i cili lind në det. Paraguaji është emeruar sipas lumit me të njëjtin emër, i cili e përshkon vendin tonë nga veriu në jug. Ai e ndan atë në dy gjysma. Në anën perëndimore të lumit ndodhet Gran Chaco, në verë aty mund të bëhet më nxehtë se 45 grad. Në krahinat e varfra me bar kullosin bagëti. Në lindje bie shi më shpesh, aty ka madje edhe pyje tropikale.



Foto: privat



Në lumin Paraguaji ekzistojnë brejtësit më të mëdhenj të tokës. Disa prej tyre bëhen mbi një metër të gjatë dhe peshojnë më shumë se 60 kilogram. Quhen Capybaras. Ata janë vegjetarian dhe ushqehen kryesisht me bar. Duken pak si derra deti (minj të mëdhenj pa bisht), me të cilët janë të afërm. Ata mund të notojnë shumë shpejt pasi kanë flatra noti midis gishtërinjve.

Kalin dhe elefantin i kam vizatuar vetë. Unë pikuroj shpesh në kohën time të lirë. Kjo më pëlqen shumë. Kur të rritem dua të bëhem mësuese vizatimi.

Të gjithë fëmijët në Paraguaji e kanë për detyrë të shkojnë në

shkollë deri në klasën e nëntë. Për momentin unë jam në klasën e katërt. Meqë si Spanjishtja ashtu edhe Guarani janë gjuhë zyrtare, ne na japin mësim në të dyja gjuhët.

Krahas lëndëve mësimore unë



marr edhe një mësim tjetër: kohët e fundit po mësoj t'i bie violinës. Edhe motra ime Verónica i bie violinës. Ajo po e mëson për një kohë më të gjatë dhe ndonjëherë luan edhe në shërbesë fetare. Verónica këndon gjithashtu edhe në korr; ajo është tashmë 18 vjeç.

Kjo është Kisha Apostolike e Re në Fernando de la Mora. Këtu unë, mamaja dhe Verónica shkojmë në shërbesat fetare,



mamaja ime Carina është mësuese e mësimit të së dielës. Bashkësia është afërsisht 20 kilometra larg nga vendbanimi ynë.



Babai im bën një rrugë më të gjatë udhëtimi se ne për në shërbesë fetare. Ai është drejtuesi i bashkësisë Ciudad del Este, që ndodhet 324 kilometra larg. Ai udhëton çdo fundjavë për atje dhe përshkon Paraguain nga lindja në perëndim. Ciudad del Este është qyteti i dytë më i madh i Paraguait. Familja ime, pra prindit e mi, motra ime dhe unë banojmë në Ñemby, një periferi e kryeqytetit të vendit Asunción. Ky është qyteti më i madh i vendit tonë dhe një nga vendet më të vjetra të Amerikës jugore.

KUTIA POSTARE




SI E FILLONI JU NJË VIT TË RI?

„Fillimin e një viti të ri unë dhe prindërit e mi dhe vëllezërit e mi e festojmë me fishekzjarre. Unë jam përgjegjës për ndezjen.“ **Matias, 12 vjeç, nga Montevideo (Uruguaji)**

„Një vit të ri unë e filloj me familjen time. Ne shkojmë në shtëpinë e Perëndisë dhe mendojmë atje për gjithë ato të mira që do të vijnë.“ **Santiago, 7 vjeç, nga La Coruña (Spanjë)**



Unë dua t'i jap kalit vitin tjetër.“ **Frederik, 5 vjeç nga Königstein në Taunus**



„Unë dëshiroj të shkoj te tezja ime, pasi ajo ka qenjë të lezetshëm.“ **Christian, 8 vjeç nga Königstein në Taunus**



Foto: Oliver Rütten

| Kisha e Jezu Krishtit

Në shtator 2015 botohet katekizmi i kishës Apostolike të Re në pyetje dhe përgjigje. Nga gjithsej 750 pyetje dhe përgjigje, community paraqet shkurtimisht disa prej tyre – në këtë botim bëhet fjalë për Kishën e Jezu Krishtit dhe për postin, detyrën.

Çfarë do të thotë „kishë“ në përgjithësi?

Termi kishë në përdorimin e përgjithshëm gjuhësor ka tre kuptime të ndryshme. Nga njëra anë do të thotë një shtëpi Zoti e krishterë (si p.sh. kisha e fshatit), ku besimtarët mbliidhen për shërbesë fetare. Në një kuptim tjetër percaktohet me kishë një bashkësi e një vendi. Përveç kësaj me fjalën kishë nënkuptohet një bashkësi e krishterë (Denomination), për shembull Kisha Apostolike e Re ose Kisha Katolike.

„Denomination“, nga latinishtja „denominatio“ („përcaktim“, „emërtim“), është një term jo fort i përshtatshëm për një komunitet fetar.

A është kisha e domosdoshme?

Po, kisha është e domosdoshme për të qenurit i krishterë, pasi vetëm tek ajo dëgjojmë fjalën e Perëndisë, marrim shenjtërimet dhe përjetojmë bashkimin me Perëndinë dhe me njëri-tjetrin. Këto komponente janë të domosdoshme në tërësinë e tyre, për të marrë shpëtimin. Pa kishën kjo nuk do të ishte e mundur për njeriun.

Si e përjetojmë anën e padukshme të Kishës së Jezu Krishtit?

Anën e padukshme të kishës e përjetojmë ndër të tjera në efektet shpëtuese. Këto janë të padukshme për njeriun dhe mund të perceptohen vetëm me besim.

Shembuj të efekteve shpëtuese janë:

- kur Perëndia fal mëkatet,
- kur me anën e pagëzimit lahet mëkati i trashëguar,
- kur Perëndia dhuron dhuntinë e Shpirtit të shenjtë,
- kur jepet Trupi dhe Gjaku i Krishtit në Darkën e shenjtë,
- kur u dhurohen shenjtërime atyre që kanë ndërruar jetë,
- kur ndërrmerren veprime bekuuese (konfirmacione, emërime etj.),
- kur Perëndia vepron në predikim me anë të fjalëve të njeriut,
- kur u jepet bekimi bashkësisë.

Si e përfjetojmë anën e dukshme të Kishës së Jezu Krishtit?

Anën e dukshme të kishës e përfjetojmë ndër të tjera, kur njerëzit veprojnë në kishë. Kjo perceptohet – për shembull,

- kur njerëzit e pranojnë, dëshmojnë, pohojnë Jezu Krishtin,
- kur festohet shërbesa fetare,
- kur shenjtërohet uji për pagëzim dhe kur kryhet pagëzimi,
- kur mbartësit e posteve shenjtërojnë bukën dhe verën për Darkën e shenjtë dhe kur e shpërndajnë atë,
- kur apostujt vendosin duart dhe kur dhurojnë Vulën e shenjtë,
- kur predikohet,
- kur bëhet lutja,
- kur praktikohet dashuria për njëri-tjetrin.

Cilën shenjë dalluese ka Kisha e Jezu Krishtit?

Kisha e Krishtit – si nga ana e dukshme, ashtu edhe nga ajo e padukshme – ka këto katër shenja dalluese: unitetin, shenjtërinë, universalitetin dhe apostolicitetin. Këto shenja dalluese të kishës i quajmë „notae ecclesiae“.

Çfarë do të thotë: „uniteti i Kishës së Jezu Krishtit“?

Kisha është një, sepse ekziston vetëm një Perëndi. Kisha dëshmon për unitetin e Perëndisë, Atit, Birit dhe Shpirtit të shenjtë që vepron tek ajo. Jezusi e ka quajtur unitetin midis njëri-tjetrit dhe dashurinë ndaj njëri-tjetrit si shenjë dalluese të atyre që i përkasin atij dhe e ndjekin pas atë. Kështu në kishë shfaqet natyra e Perëndisë: „Perëndia është dashuri; ai që qëndron në dashuri, qëndron në Perëndinë

dhe Perëndia tek ai“ (1 Gjonit 4,16).

Çfarë do të thotë: „shenjtëri e Kishës së Jezu Krishtit“?

Kisha është e shenjtë, sepse Trinia e Perëndisë është e shenjtë. Ai vepron në kishën e Krishtit në fjalë dhe shenjtërim.

Çfarë do të thotë: „universaliteti i Kishës së Jezu Krishtit“?

Kisha është universale, pasi Perëndia është aty për të gjithë njerëzit, për të gjallët dhe të vdekurit. Për shpalljen e Ungjillit nuk eksitojnë kufij.

Çfarë do të thotë: „apostoliciteti i Kishës së Jezu Krishtit“?

Kisha është apostolike, sepse tek ajo vepron puna e apostujve dhe shpallen mësimet apostolike.

Ku mund të njihesh me Kishën e Jezu Krishtit?

Me Kishën e Jezu Krishtit mund të njihesh aty ku - në shkallë të ndryshme - ekziston uniteti, shenjtërimi, universaliteti dhe apostoliciteti. Më konkretisht, Kisha e Jezu Krishtit shfaqet sot aty, ku ekziston puna e apostujve, dhurimi i tre shenjtërimeve të gjallët dhe të vdekurit si dhe aty ku shpallet fjala e duhur. Aty është puna shpëtuese e Zotit, ku bashkësia nuse e Krishtit bëhet gati për Martesën në Qiell.

Çfarë i bashkon bashkësitë e veçanta kishtarë me njëri-tjetrin?

Elemente lidhëse të bashkësive të veçanta kishtarë janë pagëzimi në emër të Perëndisë, Atit, Birit dhe Shpirtit të shenjtë, pohimi në Jezu Krisht dhe besimi në Trinitetin Perëndisë. Kisha si një bashkim i besimit, i shpresës dhe i dashurisë bëhet e njohur nëpërmjet atyre, që u pagëzuan dhe jetojnë sipas besimit të tyre dhe që e pranojnë Krishtin si Zotin e tyre.



Foto: NAK Afrika e Jugut

| Posti

Çfarë nënkuptojmë me fjalën „post“?

Në përgjithësi me fjalën „post“ nënkuptohet një funksion ose një qëndrim zyrtar, me anë të cilit janë të lidhura përgjegjësi dhe detyra konkrete. Në një kuptim tjetër mbajtësit e posteve kanë autoritetin për të drejtuar një bashkësi dhe për të marrë vendimet e duhura.

Cila është prejardhja e postit shpirtëror?

Posti shpirtëror e ka zanafillën tek ajo që Perëndia, Ati, dërgoi Jezu Krishtin. Jezu Krishti është pra i dërguari i Perëndisë. Si i tillë ai është i plotfuqishëm, i bekuar dhe i shenjtëruar për shpëtimin e njerëzve. Apostujt janë të dërguarit e Jezu Krishtit. Detyra shpirtërore qëndron gjithnjë në marrdhënie me Jezu Krishtin dhe me apostujt e dërguar prej tij. Posti dhe apostulati janë pra të lidhura me njëra-tjetrën: Aty ku vepron posti i apostujve, ekziston posti shpirtëror.

Termi „apostulat“ përdoret mbi të gjitha kur i emëron në tërësi mbajtësit e posteve („Apostulat“ = apostujt e Jezusit). Mbajtësit e

postit priftëror dhe diakonët veprojnë me porosi të „apostulatis“ dhe kryejnë detyra si kujdesin shpirtëror, shpalljen e fjalës dhe dhurimin e shenjtëtimeve.

Çfarë nënkuptojmë me „autorizim“ për punën shpirtërore?

Një post shpirtëror ngarkohet nga apostuli me porosi të Jezu Krishtit. Me këtë ai që merr postin merr edhe një pjesë nga plotëfuqia e apostulit. Këtë autorizim ai duhet ta ushtrojë në emër të apostulit. Marrësi i postit vepron kështu në emër të apostulit dhe e përfaqëson atë në tërë fushën e përcaktuar nga ky post. Së fundi apostuli shpërndan mbajtësit e posteve. Ai që dërgohet, pra vëllai i administrates, mban përgjegjësi dhe ka detyrime karshi atij që e dërgoi.

Shembuj për veprim me autorizim të plotë:

Kur apostuli shpall faljen e mëkateve, ai vepron në sajë të fuqisë së plotë marrë nga vetë Jezu Krishti. Kështu apostuli e shpall faljen e mëkateve me fjalët: „Unë ju shpall mesazhin e gëzuar: Në emër të Zotit tonë Jezu Krisht, Birit

të Perëndisë së gjallë, mëkatet i keni të falura.“ Kur mbajtësi i postit priftëror e shpall faljen e mëkateve, ai vepron në emër të apostulit. Kështu mbajtësi i detyrës priftërore e shpall faljen e mëkateve me fjalët: „Në emër të dërguesit tim, apostulit, ju shpall mesazhin e gëzuar: Në emer të Zotit tonë Jezu Krisht, Birit të Perëndisë së gjallë, mëkatet i keni të falura.“

Çfarë nënkuptojmë me „shërbime“ në Kishën e Jezu Krishtit?

Çdo i pagëzuar është thirrur për t'i shërbyer Perëndisë me dashuri vepruese ndaj të afërmit dhe të pohojë, të dëshmojë besimin (krahaso Gjoni 12,26). Nëse disa prej besimtarëve në Kishën e Krishtit iu jepen detyra dhe fusha të caktuara veprimi, të cilat kontribuojnë për të mirën e besimtarëve dhe për shpalljen e Ungjillit, atëherë këtë e kuptojmë si shërbim. Këto shërbime ushtrohen kudo ku të pagëzuarit e pranojnë besimin e tyre në Jezu Krisht si Zotin e tyre në fjalë dhe veprim.

Çfarë ndryshimi kanë shërbimet në kishën e Jezu Krishtit nga detyra shpirtërore?

Ndryshimi i shërbimeve nga detyra shpirtërore është që këto shërbime mund të ushtrohen pa emërim.

Cilin post ka themeluar Jezu Krishti?

Jezu Krishti i dha kishës së tij drejtpërdrejt vetëm një post, pikërisht atë të apostulit. Ai u dha atyre fuqinë e plotë, i bekoi, i shenjtëroi dhe i pajisi me Shpirtin e shenjtë: „Siç më dërgoi mua Ati, ashtu ju dërgoj unë ju. Pastaj fryu mbi ta dhe u tha: Merreni Shpirtin e shenjtë! Atyre që ju u falni mëkatet, ua ka falur edhe Perëndia; atyre që nuk ua falni, nuk ua ka falur as Perëndia“ (Gjon 20,21-23). Apostujve ai u besoi administrimin e shenjtërimeve. Në këtë mënyrë bëhet e arritshme për njerëzit sakrifica e tij (krhs. Mateu 28,19,20).

Fuqia e plotë e apostujve për „administrimin e shenjtërimeve“ do të thotë, se apostujt janë ngarkuar me këtë detyrë nga Jezu Krishti për dhurimin e shenjtërimeve. Edhe nëse jo të gjitha shenjtërimet dhurohen nga vetë apostujt, ato qëndrojnë gjithmonë në lidhje me postin e apostujve.

Kush e dhuron sipas Testamentit të Ri dhuntinë e Shpirtit të shenjtë?

Nga veprat e apostujve 8,15-18 del në pah se dhurimi i dhuntisë së Shpirtit të shenjtë është i lidhur me postin e apostujve: Filipi predikonte në Samari dhe i pagëzonte besimtarët me ujë. Apostujt dëgjuan për këtë dhe si pasojë dërguan atje Pjetrin dhe Gjonin. Këta „u lutën që ata ta merrnin Shpirtin e shenjtë, pasi ai nuk kishte zbritur akoma mbi asnjërin prej tyre dhe ishin pagëzuar vetëm në emër

të Zotit Jezus. Aty apostujt vendosën duart mbi ta dhe ata e morën Shpirtin e shenjtë.“ Kjo theksohet te veprat e apostujve 19,6: „Dhe, kur Pali vuri duart mbi ta, Fryma e Shenjtë zbriti mbi ta“.

Cilat ishin detyrat e tjera të rëndësishme të apostulit?

Një detyrë e rëndësishme e apostulit ishte të shpallte, se Jezu Krishti veptoi në mesin e tyre, vdiq dhe u ringjall nga të vdekurit (krhs. Veprat e Apostujve 13,26-41; 17,1-4). Ata luftuan doktrinën e urrejtjes, ku mohohet kjo gjë (krhs. 1 Korintasve 15,3-8; 1. Gjon 4,1-6).

Cili post u vendos i pari nga apostujt?

Mbas Pentakostit apostujt filluan ta përmushin detyrën e tyre dhe të predikonin Ungjillin. Së shpejti doli, se ata kishin nevojë për ndihmësa: Për këtë u përzgjodhën shtatë burra. Ata u bekuan për shërbimin e tyre nëpërmjet lutjes së apostujve dhe vendosjes së duarve mbi ta. Këta shtatë burra u cilësuan si diakonët e parë.

„I paraqitën pastaj para apostujve, të cilët, mbasi u lutën, vunë duart mbi ta.“ Veprat e Apostujve 6,6

Çfarë postesh dhe nënpostesh ekzistojnë në Kishën Apostolike të Re?

Në Kishën Apostolike të Re ekzistojnë tre nivele postesh me fuqi të ndryshme shpirtërore: Apostul, posti priftëror dhe diakonë.

- Postit të apostulit i përket: apostuli kryesor, apostuli i distriktit dhe apostujt
- Nivelit të punës së postit priftëror i përket: bishopi, kryeplaku i distriktit, evangjelisti i distriktit, bariu, drejtuesi i bashkësisë dhe prifti.
- Nivelit të punës së diakonit i përket: diakonët dhe nëndiakonët.

Shkoni në mbarë botën: Ftesë për Ditën Ndërkombëtare të Rinisë 2019



Photo: EJT Foto-team

Nga 30 maji deri në 2 qershor 2019, do të ketë një info të re për Ditën Evropiane të Rinisë – këtë herë me pjesëmarrje globale. „Do të gëzohesha, nëse me rastin e Ngjitjes në qiell 2019 do të vinin në Düsseldorf shumë të rinj nga e gjithë bota“, thotë apostuli kryesor Jean-Luc Schneider, udhëheqësi i kishës Apostolike të Re në të gjithë botën.

Në vitin 2009 erdhën 35.000 të rinj në Düsseldorf për ditën Evropiane të Rinisë. Pesë vjet më vonë udhëtuan në Mynih për Ditën Ndërkombëtare të Kishës 45.000 besimtarë. Dhe tani, pas pesë vjetësh do të jetë një ngjarje tjetër e rëndësishme. Këtë vendosën apostujt e distrikteve të Kishës Apostolike të Re në takimin e tyre gjysëm-vjetor në Johannesburg (Afrika e Jugut). Më parë apostuli i distriktit Rainer Storck, kishte prezantuar gjëndjen e planeve për Ditën Ndërkombëtare të Rinisë.

Në qëndër të Evropës

Düsseldorf-i, si vend mikpritës, ka avantazhe të shumta:

qyteti shtrihet në mes të Evropës, ka lidhje të mira me trafik rrugor dhe hekurudhor për afër dhe larg si dhe një aeroport ndërkombëtar. Kësaj i shtohet edhe fakti se vendi i zhvillimit të takimit është i njohur që nga Dita e Rinisë Evropiane 2009, gjë që e thjeshtëson shumë organizimin e saj. Një karakteristikë tipike për Düsseldorf-in në Evropë është fakti, se direkt pranë sallave të ekspozitave, shtrihet një stadium i mbuluar me 45.000 vënde. Arena (kështu quhet stadiumi) është me sistem ngrohjeje dhe mundëson me strehën e saj të lëvizshme të planifikosh pavarësisht motit.

Në oborrin e ekspozitës së Düsseldorf-it gjenden në

dispozicion salla të ndryshme organizimesh me sipërfaqe prej gati 90.000 m² që lidhen me njëra-tjetrën. Në qendrën e konferencave të kësaj ekspozite, ka edhe dhoma të tjera të ndryshme, të cilat mund të përdoren për Workshops dhe për organizime të vogla me 20 – 150 vende. Këtyre u shtohen edhe sallat e ngrënies si dhe nëntë salla fjetjeje me një sipërfaqje prej 123.000 m² vënd për 24.000 persona. Zonat e jashtme ndërmjet sallave mund të përdoren si skena në ambiente të hapura.

Pritet të vijnë më shumë se 30.000 pjesëmarrës

Për Ditën Internacionale të Rinisë 2019 janë të ftuar besimtarë të rinj të moshave nga 14 deri në 35 vjeç – pavarësisht gjëndjes së tyre familjare. Këtyre ju shtohen shoqëruesit e tyre si dhe me qindra njerëz që do ndihmojnë. Që në Ditën e Rinisë Evropiane u ndje një interes i madh edhe jashtë Evropës për t'u mbledhur në një takim ndërkombëtar të të rinjve: Kështu, në 2009 udhëtuan për në Düsseldorf më shumë se qindra pjesëmarrës nga Afrika, Amerika dhe Azia. Kësaj here, do të ketë më shumë miq e të ftuar nga e gjithë bota.

Plani i tanishëm parashikon se shërbesa fetare e hapjes do të zhvillohet në ditën e Ngritjes në Qiell. Ceremonia e madhe e hapjes është parashikuar për ditën e premte në mëngjes. Më pas do të ketë një program dyditorë në sallat e ekspozitës me prezantime të ndryshme, referate, Workshops, koncerte e shumë më tepër. Të shtunën do të ofrohet një mbrëmje muzikale. Pika kulminante dhe njëkohësisht mbyllëse për Ditën e Rinisë do të jetë shërbesa fetare e së dielës, të cilën do ta mbajë apostuli kryesor Jean-Luc Schneider.

Miq ndërkombëtarë – program ndërkombëtar

Mikpritës i Ditës Ndërkombëtare të të Rinjve është Kisha Apostolike e Re e Vestfalisë së Rinit Verior, e cila nën



drejtimin e apostulit të distriktit Armin Brinkmann organizoi në 2009 Ditën e Rinisë Evropiane. Si atëherë ashtu edhe këtë radhë, mbetet dëshira që Dita e Rinisë të organizohet nga të krishterë apostolikë nga vende dhe rajone të ndryshme. Për këtë apostuli i distriktit Rainer Storck kërkoi, që në mbledhjen e apostujve të distriktit, që të gjithë zonat e apostujve të distrikteve të mbarë botës të ndihmojnë në organizimin e programit: Ai gëzon për të gjithë miqtë nga të gjitha vendet, kulturat dhe kombet.

„Për ne si mikpritës kjo ngjarje është një nder i madh, por edhe një sfidë“, kështu u shpreh drejtuesi i kishës Apostolike të Re të Vestfalisë së Rinit Verior. „Por nga eksperiencia e vitit 2009 dhe me bashkëpunëtorët e shumtë të angazhuar të bashkësive tona, jam i sigurt se kjo do të jetë një ngjarje e arritur.“

Apostuli i distriktit është që sot mirënjohës për këdo që do të tregohet i gatshëm të ndihmojë në Fundjavën e Ngritjes në Qiell: „Ne do të na nevojiten shumë ndihmësa, për t'u kujdesur për miqtë dhe për organizimet.“ Megjithatë nuk shqetësohet, pasi „akoma dhe sot janë të shumtë ata që flasin për Ditën e Rinisë Evropiane dhe për atmosferën e veçantë. Prandaj jam i bindur, se do të arrijmë të fitojmë shumë ndihmësa, që do të ta mbështesin Ditën e Rinisë në Düsseldorf.“

Stafi i planifikimit do të fillojë në vitin 2016

Detaje të mëtejshme rreth Ditës së Rinisë 2019 janë akoma në përpunim e sipër. Për këtë është krijuar një staf planifikimi, i cili do të fillojë punën në vitin 2016. Krahas kësaj është parashikuar një koordinim i ngushtë me mbledhjen e apostulit të distriktit.

Për realizimin e Ditës së Rinisë është parashikuar krijimi i një NGO – si ne Ditën e Rinisë Evropiane 2009. Aksionerë do të jenë zona të shumta kishtarë Evropiane..



| Të reja nga Shqipëria



Apostuli Gamov dhe përkthyesi Pr. Demollari në altar

Bashkësia e Tiranës feston shërbesën e saj të parë fetare në „qiell të hapur“

Ja, erdhi edhe Shtatori – i cili qe shpallur prej javësh me rradhë, me qëllim që të gjithë ta dinin dhe askush të mos mbeste para portës së mbyllur të kishës. Lajmërimi i varur në tabelën e informacionit si jashtë ashtu edhe brenda dyerve të kishës dha informacionin: të Dielën, më 13 Shtator 2015 nuk do të ketë shërbesë fetare në Tiranë. Ajo do të mbahet në një fshat të vogël, mbas malit të Dajtit dhe mban emrin e një „Shenjtori“: Shengjergj.

Për ne do të thoshte: se të gjithë vëllezërit dhe motrat do të transportoheshin deri atje me autobuzë. Për këtë arsye një javë më parë duhet të jepnin emrat e tyre të gjithë ata, të cilët me kënaqësi dëshëronin të vinin. Vëllezërit e motrat e Tiranës duhet të ishin në oborrin e kishës që në orën 9 të mëngjesit. Më pas u bë ndarja e tyre në ato makina që kishim në dispozicion: kushdo që pati një makinë, duhet të merrte dikë me vete. Një autobus me qera kushtonte shumë, kështu që u përdorën makinat private si dhe ato të kishës. Edhe pse nuk na doli llogaria, secili gjeti një vend në makinë. Arritëm të përdorim edhe mikrobuzin e kishës, pasi apostuli Gamov e kishte patentën përkatëse.

Kishim përpara një orë udhëtim: në fillim kthesa të shumta në ngjitje të malit të Dajtit dhe po më shumë kthesa në zbritje të po këtij mali nëpër luginën e lumit Erzen. Atje u ndjemë shumë mirë nën rrezet e diellit si dhe me një ajër të freskët e më të pastër se në Tiranë.

Me qëllim që të mbanin shërbesën fetare kishim kontaktuar me pronarin e një restoranti të vogël. Ai ra dakort që ne të mbanin jashtë një shërbesë fetare dhe së fundi ai do të kujdesej që të hanin të gjithë një drekë të thjeshtë. E me të vërtetë, gjithçka qe përgatitur shumë mirë: një tavoline, e cila mund të zbukurohej si një altar, numri i duhur i karrigeve, me qëllim që gjithkush të mund ta ndiqte ulur shërbesën fetare. Me pak punë u vendos gjithçka në rregull: kutitë e sakrificave u vendosën, Altari u ngrit e u zbukuroa me lule. Nuk mungoi as edhe tabela me emblemën tonë – pasi gjithkush duhet ta marrë vesh se kush jemi dhe se ku mund të na gjejnë përsëri. Përsa i përket shoqërimit muzikor na shërbeu një organo me rrotullim me dorë nga gjermania, ku mund të luheshin edhe këngët e kishës.

Shërbesa fetare filloi në orën 11. Në fillim të shërbesës fetare u këndua kënga „Lëvdoni Zotin“ po me atë organo me rrotullim me dorë, më pas erdhi lutja dhe predikimi i Apostulit Gamov, i përkthyer nga prifti Demollari. Si bazë për atë shërbesë fetare shërbeu fjala e marrë nga Malaki 3,18, me të cilën edhe apostuli kryesor kish shërbyer para pak kohësh në Armeni. Pasuan këngë të tjera, falja e mëkateve dhe Darka e Shenjtë si dhe bekimet e fundit. E me këto të fundit edhe bashkësia e Tiranës përjetoi shërbesën e saj fetare të parë „open-air“.

Direkt mbas mbylljes së shërbesës u bë edhe ngrënia e përbashkët e drekës me të gjithë motrat e vëllezërit. Shumë shpesh u përdor edhe organoja me rrotullim me dorë – këtë rradhë me muzikë nga bota, por takimi vazhdoi me këngë të shumta, me tregime e me të qeshura të shumta.



Bashkësia duke ngrënë drake në Shëngjergj

Më në fund erdhi ora për t'u kthyer. Përsëri rreth një orë nëpër rrugët me kthesa – por secili mori me vetë atë ndjesi që kishin përjetuar, duke kaluar një të dielë të veçantë e të këndëshme në mesin e motrave e vëllezërve.

Diakoni i ri para marrjes së detyrës nga Ap. Otten



Foto: NAK Shqipëri



Foto: NAK Shqipëri

Apostoli Otten dhe diakoni i ri Alfred Gogu

Bashkësia e Elbasanit fiton një Diakon të ri

Apostuli Otten mbajti një shërbesë fetare ditën e dielë, më 11 Tetor. Në këtë shërbesë fetare u emërua një diakon për bashkësinë e Elbasanit, i cili do të ndihmojë në të ardhmen bashkësinë e vendlindjes së tij, do të kujdeset për anëtarët e bashkësisë së tij dhe do të bëhet një ndihmesë në të gjitha punët e tjera. Ai quhet Alfred Gogu dhe midis shokëve ai quhet shkurt Redi.

Ai ka lindur më 10 Mars 1977 në Elbasan. Në moshën 20 vjeçare ai njohu gruan e tij Ajkuna dhe u bënë shokë të mirë. Për arsyet e vështira ekonomike që pati Shqipëria Redi u nis për në Francë dhe në Gjermani ku punoi për disa vite. Së fundi u kthye përsëri në Shqipëri dhe hapi një dyqan të vogël me vegla këmbimi. Tashmë e fiton bukën e gojës me blerje dhe shitje makinash të përdorura. Për këtë ai ka ndihmën e vëllait të tij i cili banon së bashku me familjen e tij në Stuttgart.

Redi dhe Ajkuna kanë një djalë, Reand (i quajtur Rei), i cili ka lindur në Elbasan më 6 Tetor 2005.

Një ditë kjo familje shkoi në Kuçovë për tek nëna e Ajkunës, ku takuan edhe kryeplak Rafaelin. Ai i ftoi në kishë. Nuk kishën rënë më parë në kontakt me kishën dhe nuk kishin asnjë ide se çfarë bëhej atje. Shërbesa fetare iu duk kësaj familje diçka e veçantë, ata u impresionuan nga mënyra e mbajtjes së kësaj shërbese. Po atë ditë e pyetën kryeplakun nëse kishte kishë edhe në Elbasan dhe ai u dha adresën e

kishës. Menjëherë të dielën tjetër, që 8 Shkurti 2015, ata shkuan në shërbesë. Po atë ditë vendosën t'ia bashkoheshin kishës apostolike të re, pasi ajo ua mbushi shpirtin dhe zemrën me gëzim dhe me forcë. Ata e thonë vetë se kanë gjetur paqen dhe vërtetësinë.

Ne gëzojmë së bashku me bashkësinë e Elbasanit, i urojmë çdo ditë diakonit dhe familjes së tij gëzim në Krisht dhe do t'i përfshijmë ata gjithnjë në lutjet tona.

Vizita në Shën Gjergj

U takuam të gjithë motrat e vëllezërit dhe u bëmë gati për të hipur në makinë. Ishim shumë të gëzuar, që po shkonim në Shën Gjergj. Rrugës shihnim fushat dhe kodrat plot gjelbërim, që të impresiononin pa masë. Zbritëm nga makina dhe u bëmë gati për një shërbesë të shkurtër. Shërbesa u drejtua nga apostuli Gamov dhe u përkthye nga vëllai ynë Elton. Shërbesa zgjati pak dhe të gjithë filluam të shihnim vendin, që na dukej krejtësisht një gjë e rrallë. Lumi i afronte më tepër njerëzit drejt tij. Ai lum ishte një mrekulli e rrallë; uji i tij që i mrekullueshëm, i ftohtë si akulli.

U lutëm që të gjithë në tavolinë dhe hëngrëm një drekë të shijshme. Gjëja më e mrekullueshme ishte Trofta, peshku, i cili ishte i shijshëm. Dreka na shijonte më tepër me muzikën, që luante vëllai ynë Jürgen.

Erdhi koha për t'u kthyer. Të gjithë hipëm në makinë. Peisazhi i Shën Gjergjit dhe i Dajtit ishte i mrekullueshëm; për të mos u harruar. Të gjithë u takuam me njëri-tjetrin dhe morëm rrugët për në shtëpitë tona.

Rakela Lilaj

Programi

- 03.01.2016 Siegen (Gjermani)
- 10.01.2016 Uyo Obio (Nigeri)
- 12.01.2016 Yamoussoukro (Bregu i Fildishtë)
- 07.02.2106 Ulm (Gjermani)
- 14.02.2016 Berlin (Gjermani)
- 19.02.2016 Lubango (Angola)
- 21.02.2016 Luanda (Angola)
- 27.02.2016 Muanda (Republika Demokratike e Kongos)
- 28.02.2016 Kinshasa (Kryeqyteti i R. D. të Kongos)
- 06.03.2016 Bielefeld (Gjermani)
- 13.03.2016 Zyrih (Svicër)
- 20.03.2016 Kimberli (Afrika e Jugut)
- 25.03.2016 Nordheide (Gjermani)
- 27.03.2016 Bremen (Gjermani)

